



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 51

2002

Gusht

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.384, datë 8.8.2002	Për revokimin e vendimit nr.62, datë 7.3.2002 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, të vilës 30”, ndryshuar me vendimin nr.254, datë 13.6.2002 të Këshillit të Ministrave dhe të vendimit nr.270, datë 20.6.2002 të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien në përdorim të përkohshëm të disa apartamenteve në godinën nr.57, në Bulevardin “Zogu I””.....
	1483
Vendim i KM nr.387, datë 8.8.2002	Për dhënie fondi ndihmë partive politike të reja.
	1483
Vendim i KM nr.388, datë 8.8.2002	Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Bullgarisë për vendosjen e regjimit të lehtësuar të vizave për shtetasit e të dy vendeve.....
	1484

Vendim i KM nr.389, datë 8.8.2002	Për trajtimin e punonjësve që dalin të papunë nga procesi i ristrukturimit të uzinës mekanike në Gramsh.....	1488
Vendim i KM nr.390, datë 15.8.2002	Për ruajtjen dhe sigurimin e disa objekteve shtetërore.....	1489
Vendim i KM nr.391, datë 15.8.2002	Për krijimin, shtrirjen territoriale dhe klasifikimin e zonës doganore në vendkalimin kufitar Rips.....	1489
Vendim i KM nr. 397, datë 15.8.2002	Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike, "New York University-Tirana".....	1490
Vendim i KM nr.399, datë 22.8.2002	Për disa shtesa në vendimin nr.34, datë 7.1.1999 të Këshillit të Ministrave "Për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare dhe trajtimin e personaliteteve të larta".....	1490
Vendim i KM nr. 401, datë 22.8.2002	Për disa shtesa në vendimin nr. 726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", me ndryshimet përkatëse".....	1491
Vendim i KM nr. 402, datë 22.8.2002	Për përcaktimin e kuotës financiare që përfitojnë nga shteti personat pa të ardhura, që jetojnë në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore, për shpenzime vetjake.....	1492
Udhëzim i Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr.7, datë 14.8.2002	Për organizimin e sistemit të adresave në qytete	1492
Urdhër i Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 8, datë 14.8.2002	Për transferimin e dokumenteve të gjendjes civile të shtetasve që kanë ndryshuar vendbanimin.....	1493

V E N D I M
Nr. 384, datë 8.8.2002

**PËR REVOKIMIN E VENDIMIT NR.62, DATË 7.3.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, TË VILËS 30”,
NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.254, DATË 13.6.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
DHE TË VENDIMIT NR.270, DATË 20.6.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR
DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM TË DISA APARTAMENTEVE NË
GODINËN NR.57, NË BULEVARDIN “ZOGU I””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 121 pika 1, 122 pika 2 shkronja “b” dhe 124 pika 1 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Revokimin e vendimit nr.62, datë 7.3.2002 i Këshillit të Ministrave “Për dhënie në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, të vilës 30”, ndryshuar me vendimin nr.254, datë 13.6.2002 të Këshillit të Ministrave dhe të vendimit nr.270, datë 20.6.2002 të Këshillit të Ministrave “Për dhënie në përdorim të përkohshëm të disa apartamenteve në godinën nr. 57, në bulevardin “Zogu I””.

2. Në vendimin nr.34, datë 7.1.1999 të Këshillit të Ministrave “Për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare dhe trajtimin e personaliteteve të larta”, në listën nr.1 të kreut I “Për rrethin e Tiranës” shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

“5. Vila 30, me gjithë territorin përreth saj”.

3. Komisioni i Shërbimit Civil dhe Instituti i Trajnimit të Administratës Publike t’i bëjë dorëzimet përkatëse Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare për vilën 30.

4. Komisionit të Shërbimit Civil dhe Institutit i Trajnimit të Administratës Publike t’u jepen në përdorim të përkohshëm mjediset që ka pasur në përdorim në godinën 57, në bulevardin “Zogu I”.

5. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 387, datë 8.8.2002

PËR DHËNIE FONDI NDIHMË PARTIVE POLITIKE TË REJA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18 të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Dhënie e një fondi, si ndihmë financiare, partive politike të reja, si më poshtë vijon:

- Partisë Kristian-Demokrate të Shqipërisë 100 000 (njëqind mijë) lekë.

- Partisë Aleanca Socialiste e Shqipërisë 100 000 (njëqind mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga fondet buxhetore të vitit 2002 për partitë politike.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 388, datë 8.8.2002

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË BULLGARISË PËR VENDOSJEN E REGJIMIT TË LEHTËSUAR TË VIZAVE PËR SHTETASIT E TË DY VENDEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 dhe 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Bullgarisë për vendosjen e regjimit të lehtësuar të vizave për shtetasit e të dyja vendeve. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË BULLGARISË PËR VENDOSJEN E REGJIMIT TË LEHTËSUAR TË VIZAVE PËR SHTETASIT E TË DY VENDEVE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Bullgarisë, të quajtura në vijim "Palët Kontraktuese",

Të udhëhequra nga dëshira për zhvillim dhe thellim të mëtejshëm të marrëdhënieve miqësore midis dy vendeve,

Duke pasur parasysh gjendjen dhe perspektivat për bashkëpunim midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Bullgarisë,

Në përpjekje për të lehtësuar kontaktet midis qytetarëve të të dy vendeve,

Ranë dakort për sa vijon:

Neni 1

1. Qytetarët e secilës Palë Kontraktuese hyjnë, qëndrojnë dhe dalin nga shteti i Palës tjetër Kontraktuese me vizë për qëndrim afatshkurtër ose për kalim tranzit, me përjashtim të rasteve të parashkuara në nenin 2 pika 1 dhe në nenin 3 të kësaj Marrëveshje.

2. Qytetarët e shteteve të secilës prej Palëve Kontraktuese janë të detyruar të respektojnë legjislacionin e Palës Kontraktuese në territorin e së cilës hyjnë dhe qëndrojnë.

Neni 2

1. Qytetarët e shteteve të secilës Palë Kontraktuese, të cilët mbajnë pasaporta diplomatike apo shërbimi, mund të hyjnë, të qëndrojnë për një afat prej 90 ditësh brenda 6 muajve, duke filluar nga data e hyrjes së parë dhe të largohen nga territori i Palës tjetër Kontraktuese pa viza, në qoftë se nuk ushtrojnë veprimtari fitimprurëse. E drejta e qëndrimit mund të zgjatet në përputhje me legjislacionin e shtetit të Palës pritëse Kontraktuese.

2. Qytetarët e shtetit të njëres prej Palëve Kontraktuese, që janë emëruar në punë në përfaqësinë diplomatike, konsullore ose në ndonjë përfaqësi tjetër të shtetit të tyre në shtetin e Palës tjetër Kontraktuese apo në përfaqësinë e ndonjë organizate ndërkombëtare në territorin e shtetit të

Palës tjetër Kontraktuese, të cilët mbajnë pasaporta diplomatike ose shërbimi, të lëshuara nga Ministria e Punëve të Jashtme e Palës dërguese Kontraktuese, marrin viza për hyrjen e tyre të parë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

3. Në përputhje me rregullat e Konventës së Vjenës të vitit 1961 "Për marrëdhëniet diplomatike", dispozita në paragrafin 1 përfshin edhe bashkëshortët/bashkëshortet e personave të parashikuar në paragrafin 1 dhe fëmijët e tyre.

Neni 3

1. Pas hyrjes në shtetin e Palës pritëse Kontraktuese, qytetarët e shtetit tjetër të Palës Kontraktuese, që kanë marrë viza sipas nenit 2 paragrafi 2 dhe paragrafi 3 të kësaj Marrëveshje, pajisjen nga Ministria e Punëve të Jashtme e Palës Kontraktuese pritëse me viza ose leje qëndrimi të vlefshme për një vit, të cilat japin të drejtën për hyrje-dalje shumëkalimshe dhe qëndrim sipas këtij afati.

2. Vizat ose lejet e qëndrimit për personat e përcaktuar në paragrafin 1 rinovohen çdo vit deri në fund të qëndrimit zyrtar në vendin e akreditimit.

Neni 4

Qytetarët e shteteve të secilës Palë Kontraktuese, anëtarë të ekuipazheve të mjeteve ajrore të aviacionit civil, të cilët kryejnë fluturime të rregullta sipas aneksit 9 të Marrëveshjes së Çikagos të vitit 1944 "Për aviacionin civil ndërkombëtar", si dhe fluturime charter apo speciale mund të hyjnë dhe të qëndrojnë deri në 72 orë pa viza, duke filluar nga data e hyrjes, pa paguar taksa, duke paraqitur pasaportën dhe vërtetimin e anëtarësisë në ekuipazh dhe me kusht që të jetë i përfshirë në deklaratën kryesore të fluturimit.

Neni 5

Kur paraqesin kërkesë për vizë për qëndrim afatshkurtër ose për kalim tranzit, qytetarët e shtetit të secilës Palë Kontraktuese duhet të dokumentojnë bindshëm kërkesën për vizë, ndër të tjera, edhe nëpërmjet paraqitjes së ftesës zyrtare.

Neni 6

Përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të secilës prej Palëve Kontraktuese, pas paraqitjes së ftesës zyrtare, mund t'u japin viza njëkalimshe me të drejtë qëndrimi deri në 90 ditë brenda 6 muajve, duke filluar nga data e hyrjes së parë, qytetarëve të shtetit tjetër të Palës Kontraktuese, përfaqësuesve të firmave ose organizatave me qëllim jofitimprurës, të cilat janë të regjistruara sipas legjislacionit të secilit vend.

Neni 7

1. Ftesë nuk kërkohet kur paraqiten dokumentet zyrtare për:

- (1) vizitë pranë anëtarëve të familjes ose të afërmëve të sëmurë rëndë;
- (2) pjesëmarrje në varrim ose homazhe në varret e anëtarëve të familjes ose të të afërmëve;
- (3) shoqërim të ndihmës humanitare;
- (4) pronësi mbi pasuri të paluajtshme apo të drejtë trashëgimie;
- (5) pjesëmarrje në proces hetimor ose gjyqësor.

2. Ftesë nuk kërkohet, gjithashtu, për udhëtime turistike të organizuara, kur paraqitet dokument për shërbime turistike të parapaguara, sipas legjislacionit të shtetit të Palës Kontraktuese pritëse.

Neni 8

1. Përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të secilit prej shteteve Palë Kontraktuese mund t'u

japin viza shumëkalimshe me afat deri në një vit dhe me të drejtë qëndrimi deri 90 ditë brenda gjashtë muajve, duke filluar nga data e hyrjes së parë, qytetarëve të shtetit tjetër të Palës Kontraktuese, përfaqësues të firmave apo organizatave me qëllim jofitimprurës, të regjistruara sipas legjislacionit të secilit vend, të cilët paraqesin dokumente që vërtetojnë praninë e kontakteve afatgjata të punës.

2. Përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Palëve Kontraktuese mund t'u japin viza shumëkalimshe me afat deri në një vit dhe me të drejtë qëndrimi deri 90 ditë brenda 6 muajve, duke filluar nga data e hyrjes së parë, qytetarëve të Palës tjetër Kontraktuese, drejtues të automjeteve të transportit ndërkombëtar kur paraqesin dokumente që vërtetojnë kryerjen e transportit të udhëtarëve ose mallrave.

Neni 9

1. Qytetarët e shtetit të secilës Palë Kontraktuese janë të detyruar të njoftojnë menjëherë autoritetet kompetente të shtetit të Palës Kontraktuese pritëse në rast se humbasin pasaportën ose ndonjë dokument tjetër udhëtimi, me të cilin janë futur në territorin e tij. Autoritetet kompetente të shtetit të Palës Kontraktuese pritëse u japin dokument që vërteton njoftimin e tyre, pa paguar taksë.

2. Përfaqësia diplomatike ose konsullore e shtetit të Palës Kontraktuese, nënshtetësinë e të cilit kanë personat sipas paragrafit 1, u jep dokument të ri udhëtimi me të cilin ata mund të largohen nga territori i shtetit të Palës Kontraktuese pritëse, në përputhje me legjislacionin e tij.

Neni 10

1. Përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të shteteve të Palëve Kontraktuese u japin viza për qëndrim afatshkurtër pa pagesë të taksave administrative dhe taksave për vizë qytetarëve të shtetit tjetër të Palës Kontraktuese, të cilët janë:

- pjesëmarrës në shkëmbimin shkencor, kulturor, mësimor dhe sportiv dypalësh ose shumëpalësh, të zhvilluar në bazë të marrëveshjeve ndërqeveritare;
- fëmijë që nuk kanë mbushur moshën 12 vjeç;
- persona që kanë kaluar moshën 65 vjeç.

2. Përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të shteteve të Palëve Kontraktuese u japin viza për qëndrim afatshkurtër pa pagesë të taksave administrative, taksave për vizë dhe taksave për lejen e qëndrimit qytetarëve të shtetit tjetër të Palës Kontraktuese, të cilët janë nxënës, studentë, doktorantë dhe specialistë që studiojnë në bazë të marrëveshjeve ndërqeveritare në institucione arsimore në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 11

1. Me dorëzimin e kërkesës për dhënien e vizës, qytetarët e secilës Palë Kontraktuese paguajnë taksë administrative, përveç rasteve të parashikuara në nenin 2 paragrafi 1, në nenin 3 dhe në nenin 10. Palët Kontraktuese njoftojnë reciprokisht, në rrugë diplomatike, nëpërmjet shkëmbimit të notave, për masën e taksës administrative.

2. Vizat dhe lejet e qëndrimit për personat sipas nenit 2 dhe nenit 3 jepen pa pagesë (nuk u merrret taksa).

Neni 12

1. Palët Kontraktuese informojnë reciprokisht, në rrugë diplomatike, nëpërmjet shkëmbimit të notave, të paktën 30 ditë përpara futjes në qarkullim të modeleve të reja të dokumenteve për udhëtim ose para kryerjes së ndryshimeve në dokumentet e shënuara në aneksin e kësaj Marrëveshjeje dhe paraqesin modelet e tyre.

2. Palët Kontraktuese shkëmbejnë informacion në rrugë diplomatike, ndërsa në rast nevojë, zhvillojnë konsultime lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 13

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje mund të ndryshohen dhe të plotësohen nëpërmjet shkëmbimit në rrugë diplomatike të notave me tekste të njëjta. Ndryshimet dhe plotësimet hyjnë në fuqi ditën e tridhjetë pas ditës së marrjes së notës së dytë, me të cilën Palët Kontraktuese njoftojnë reciprokisht plotësimin e procedurave të tyre të brendshme.

Neni 14

1. Në raste të jashtëzakonshme (epidemi, fatkeqësi natyrore, për arsye të mbrojtjes së sigurisë kombëtare ose të rendit publik dhe për raste të ngjashme), secila nga Palët Kontraktuese mund të ndërpresë përkohësisht, plotësisht ose pjesërisht zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

2. Ndërprerja dhe rivënia në zbatim e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje hyn në fuqi brenda në afati prej 24 orësh nga kthimi i njoftimit me shkrim nga Pala tjetër Kontraktuese.

Neni 15

Kjo Marrëveshje përfundohet për një afat të pacaktuar dhe secila nga Palët Kontraktuese mund ta ndërpresë veprimin e saj pas një njoftimi me shkrim në rrugë diplomatike 60 ditë përpara.

Neni 16

Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje pushon së vepruari Marrëveshja midis Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Bullgarisë për vendosjen e regjimit të lehtësuar të vizave, e nënshkruar më 18 maj 1992 në Sofje.

Neni 17

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas kalimit të afatit 30 ditor nga marrja e notës së fundit, me të cilën Palët Kontraktuese informojnë se i kanë plotësuar kërkesat e legjislacionit të tyre të brendshëm për hyrjen e saj në fuqi.

Nënshkruar në Sofje më 31.5.2002 në dy ekzemplarë, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën bullgare dhe të dy tekstet janë të barazvlefshme.

V E N D I M **Nr. 389, datë 8.8.2002**

PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE QË DALIN TË PAPUNË NGA PROCESI I RISTRUKTURIMIT TË UZINËS MEKANIKE NË GRAMSH

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "a" të pikës 2 të nenit 112 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative", të nenit 4 të ligjit nr.8571, datë 27.1.2000 "Për miratimin e dokumentit të politikës së mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë", të nenit 8 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1995 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të nenit 29.1 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 7 të ligjit nr.8847, datë 19.12.2001 "Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2002", ndryshuar me ligjin nr.8903, datë 23.5.2002, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Uzina mekanike në Gramsh t'i nënshtrohet procesit të ristrukturimit.
2. Punonjësit e kësaj uzine, që mbeten të papunë nga ky proces, të trajtohen financiarisht për periudhën nga 1.1.2002 deri më 31.12.2002, me pagë mujore prej 13 596,4 lekësh, ku përfshihen dhe sigurimet e detyrueshme.

Pagesat të bëhen njëherazi nga zyra përkatëse e punësimit, me fondet që, sipas pikës 5 të këtij vendimi, i janë shtuar Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale.

3. Kjo periudhë pagese t'u njihet këtyre punonjësve si vjetërsi në punë, për efekt pensioni, dhe të shënohet e tillë në librezën e punës pasi të bëhet pagesa e kontributit për sigurimet shoqërore, në përputhje me ligjin.

4. Të drejtën e trajtimit sipas këtij vendimi e kanë punonjësit të cilët në datën 31.12.2001 kanë qenë në marrëdhënie pune, pa ndërprerje, ose janë trajtuar me pagesë gatishmërie në uzinën mekanike Gramsh, për një periudhë kohe jo më pak se një vit.

5. Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e miratuar për vitin 2002, në zërin "Mallra e shërbime", t'i pakësohet fondi prej 16 642 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e dyzet e dy mijë) lekësh. Ky fond t'i shtohet Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale në buxhetin e miratuar për vitin 2002.

6. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale për nxjerrjen e udhëzimit përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 390, datë 15.8.2002

PËR RUAJTJEN DHE SIGURIMIN E DISA OBJEKTEVE SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe shkronjës "e" të neneve 3 shkronja "e" dhe 58 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit", me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria e Rendit Publik të ruajë dhe sigurojë, me punonjës të Policisë së Shtetit, objektet shtetërore, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Numri i punonjësve të policisë të përcaktohet me marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Rendit Publik dhe institucionit përkatës.

3. Fondi i pagave dhe i shpenzimeve të përballohet nga subjektet e përcaktuara në listën e pikës 1.

4. Ngarkohen Ministria e Rendit Publik, Ministria e Industrisë dhe Energjetikës, Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

LISTA E OBJEKTEVE SHTETËRORE QË DO TË MERREN NË RUAJTJE
NGA POLICIA E SHTETIT

1. Aeroporti Rinas, Tiranë
2. Porti Detar, Durrës
3. HEC Vau – Dejës, Shkodër
4. KPTHN Ballsh dhe FEIK, Vlorë
5. Uzina e Azotikun, Fier
6. Banka e Shqipërisë (vlerat monetare në lëvizje)

V E N D I M
Nr. 391, datë 15.8.2002

**PËR KRIJIMIN, SHTRIRJEN TERRITORIALE DHE KLASIFIKIMIN E ZONËS
DOGANORE, NË VENDKALIMIN KUFITAR RIPS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 5 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 "Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e zonës doganore të përhershme, në vendkalimin kufitar Rips, në kufirin tokësor të Republikës së Shqipërisë me Republikën e Greqisë.
2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 397, datë 15.8.2002

**PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE,
JOPUBLIKE "NEW YORK UNIVERSITY-TIRANA"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 1, 12 dhe 13 të ligjit nr. 8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Dhënie e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike, "New York University - Tirana", sipas kriterëve të përcaktuara në vendimin nr.156, datë 22.3.2001 të Këshillit të Ministrave "Për shkollat e larta jopublike në Republikën e Shqipërisë".

2. Shkolla e lartë univesitare jopublike "New York University - Tirana" do të japë gradën (diplomën) BACHELOR, në fushat e mëposhtme:

A. Administrim biznesi:

- kontabilitet,
- finanacë,
- marketing,
- menaxhim,
- ekonomik.

B. Shkenca kompjuterike

C. Gjuhë dhe letërsi angleze

3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kryerjen e procesit të vlerësimit dhe akreditimit të njohjes së kurseve të studimit dhe të zbatimit të ligjshmërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 399, datë 22.8.2002

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.34, DATË 7.1.1999, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, "PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERTARE DHE TRAJTIMIN E
PERSONALITETEVE TË LARTA"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.34, datë 7.1.1999, të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa;

1.Në fund të pikës 11 të shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Këtë trajtim e përfitojnë Presidenti i Republikës dhe Kryeministri, për periudhën nga dita e emërimit deri në fillimin e detyrës".

2.Në fund të pikës 15 të shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Ish-Presidentit, ish-Kryeministrit dhe ish-Kryetarit të Kuvendit, për periudhat kohore, respektive, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, sipas mundësisë, u siguron mjedise të domosdoshme pune, kundrejt tarifave të caktuara nga kjo drejtori".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 401, datë 22.8.2002

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 726, DATË 21.12.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE", ME
NDRYSHIMET PËRKATËSE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 e 6 të ligjit nr. 8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", me ndryshimet përkatëse të bëhen këto shtesa:

1. Në lidhjen nr. 1 "Renditja e funksioneve sipas klasifikimit" shtohen këto emërtime:

- Në klasifikimin A7 "Sekretar i Përgjithshëm në Prokurorinë e Përgjithshme".

- Në klasifikimin A10 "Shef i Kabinetit të Prokurorit të Përgjithshëm"

LIDHJA II-32
NIVELI I PAGËS PËR PUNONJËSIT E ADMINISTRATËS
SË PROKURORISË SË PËRGJITHSHME

Nr.	Emërtimi	Klasifikimi
1.	Sekretar i Përgjithshëm	A7
2.	Shef Kabineti	A10
3.	Këshilltar, drejtor drejtorie	A12
4.	Përgjegjës sektori	B4
5.	Zëdhënës shtypi, inspektor kontrolli, përkthyes, përgjegjës zyre	B5
6.	Specialist, jurist, sekretar i Prokurorit të Përgjithshëm	C2

Nr.	Emërtimi	Klasifikimi
1.	Oficer informacioni dhe i ruajtjes së rendit	VIII
2.	Teknik mirëmbajtjeje, operator, magazinier, arkëtar	VII
3.	Shofer, punonjës shërbimi	V
4.	Punëtore pastrimi	III

- Në klasifikimin A12 “Këshilltar i Prokurorit të Përgjithshëm, drejtor drejtorie në Prokurorinë e Përgjithshme”.

- Në klasifikimin B4 “Përgjegjës sektori në Prokurorinë e Përgjithshme”.

- Në klasifikimin B5 “Zëdhënës i Prokurorit të Përgjithshëm”; në Prokurorinë e Përgjithshme”; Inspektor kontrolli në Prokurorinë e Përgjithshme; “Përkthyes në Prokurorinë e Përgjithshme”.

- Në klasifikimin C2 “Specialist jurist në Prokurorinë e Përgjithshme”, “Sekretar i Prokurorit të Përgjithshëm”.

2. Shtohet lidhja II-32 dhe II-M “Niveli i pagës për punonjësit e administratës së Prokurorisë së Përgjithshme”, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga fondet buxhetore të vitit 2002, miratuar për Prokurorinë e Përgjithshme.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 gusht 2002.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M

Nr. 402, datë 22.8.2002

PËR PËRCAKTIMIN E KUOTËS FINANCIARE QË PËRFITOJNË NGA SHTETI PERSONAT PA TË ARDHURA, QË JETOJNË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË PËRKUJDESJES SHOQËRORE, PËR SHPENZIME VETJAKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 14, të ligjit nr.7710, datë 18.3.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore", me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Masa e kuotës për shpenzime vetjake për të moshuarit, pa të ardhura, që jetojnë në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore, është 10 për qind e kostos mesatare mujore të muajit paraardhës.

2. Masa e kuotës për shpenzime vetjake për fëmijët e moshës 6-14 vjeç, që jetojnë në shtëpitë e fëmijëve, është 500 (pesëqind) lekë në muaj.

3. Masa e kuotës për shpenzime argëtimi, e depozituar nga institucioni dhe e përdorur me urdhër të titullarit, për fëmijët e moshës 0-6 vjeç, që jetojnë në shtëpitë e fëmijëve, është 250 (dyqind e pesë dhjetë) lekë në muaj, ndërsa për personat që jetojnë në qendrat e zhvillimit është 300 (treqind) lekë në muaj.

4. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i vitit 2002, i miratuar për Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale.

5. Ngarkohet Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të nxjerrë udhëzimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

U D H Ë Z I M
Nr. 7, datë 14.8.2002

PËR ORGANIZIMIN E SISTEMIT TË ADRESAVE NË QYTETE

Në mbështetje të pikës 4 neni 102 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, për të lehtësuar plotësimin e kompetencës së bashkive dhe komunave, në përputhje me nenin 32 pika 11 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin e funksionimit të qeverisjes vendore", për t'iu përgjigjur ndryshimeve të mëdha në urbanistikë, sidomos në qytete, për të lehtësuar shërbimin e gjendjes civile dhe shërbimeve të tjera publike,

U D H Ë Z O J:

1. Të studiohet gjendja e emërtimeve të rrugëve dhe të shesheve publike të qytetit dhe të procedohet me përcaktimin e emrave të të gjitha rrugëve e shesheve që nuk janë të emërtuara.
2. Të bëhet përcaktimi në planimetri i numrave të pallateve, banesave, të shkallëve dhe të apartamenteve.
3. Të publikohen vendimet e këshillave vendore për emërtimet e rrugëve dhe shesheve të reja, si dhe planimetria e aktualizuar e qytetit, e cila duhet t'u dërgohet zyrtarisht për dijeni e veprime institucioneve të interesuara, në mënyrë të veçantë zyrave të gjendjes civile, komisioneve të zgjedhjeve të qeverisjes vendore (KZQV-së) dhe prefekturave.
4. Brenda mundësive financiare të bashkive, të punohet për vendosjen në terren të tabelave me emërtimet e rrugëve, shesheve, numrat e pallateve e të shkallëve, në ratet kur ato mungojnë ose kanë nevojë të rinovohen.
5. Të stimulohet hartimi i guidave të qyteteve me emrat e rrugëve e të shesheve të shkruara qartë, si dhe me shpjegimet përkatëse.
6. Në bashkitë e mëdha të studihet mundësia e hapjes së "Zyrës së adresave", si një institucion që përmbledh informacionin për gjendjen dhe ndryshimet e adresave në proces, duke përcaktuar mënyrën e organizimit dhe funksionimit të saj.
7. Të bëhet bilanci i shpenzimeve që duhen kryer për mbarëvajtjen e këtij procesi dhe, në përputhje me mundësitë financiare të bashkisë, t'i propozohet këshillit bashkiak angazhimi i fondeve në këtë proces për vitin buxhetor në vazhdim dhe për vitin 2003.
8. Problemet e paraqitura në pikat 1 deri 3 (përfshirë) duhet të realizohen brenda vitit 2002, ndërsa problemet e tjera të plotësohen në raport me mundësitë financiare që krijohen, në bazë të përcaktimit të fondeve nga këshilli i bashkisë.

MINISTRI I PUSHTETIT VENDOR
DHE DECENTRALIZIMIT
Ben Blushi

U R D H Ë R
Nr. 8, datë 14.8.2002

**PËR TRANSFERIMIN E DOKUMENTEVE TË GJENDJES CIVILE TË SHETETASVE
QË KANË NDRYSHUAR VENDBANIMIN**

Në mbështetje të pikës 4 neni 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.14, datë 24.1.1994 "Për ndryshimin e vendbanimit të shtetasve shqiptarë", ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.162, datë 18.3.1996,

U R D H Ë R O J:

1. Të gjitha zyrat e gjendjes civile që i përkasin vendbanimit të ri të shtetasve të shqyrtojnë kërkesat e paraqitura për transferimin e fletëfamiljes dhe të dërgojnë njoftimin në zyrat e gjendjes civile të vendbanimit të vjetër, ku ndodhet regjistri themeltar. Për kërkesat e bëra më parë, njoftimi të dërgohet jo më vonë se data 31 gusht, ndërsa për çdo kërkesë të re, njoftimi në zyrën përkatëse të dërgohet jo më vonë se brenda 5 ditëve nga bërja e kërkesës nga ana e shtetasit.

2. Zyrat e gjendjes civile të vendbanimit të vjetër të shtetasve, që kanë marrë njoftimin nga zyrat e gjendjes civile të vendbanimit të ri, për transferimin e fletës së regjistrit themeltar, të plotësojnë dokumentacionin e kërkuar dhe t'i dërgojnë ato në zyrat përkatëse, brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së njoftimit.

3. Zyrat e gjendjes civile të vendbanimit të ri të shtetasve të dërgojnë në zyrat përkatëse të vendbanimit të vjetër, konfirmimin e marrjes së fletës së regjistrit themeltar të vendbanimit të vjetër të shtetasve. Ky çregjistrim të bëhet brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit.

Nën drejtimin e kryetarit të komunës ose të bashkisë, zyrat e gjendjes civile, brenda periudhës gusht-shtator, të bëjnë verifikimin e gjendjes së familjeve e shtetasve të larguar nga vendbanimi ku kanë regjistrin themeltar, duke kërkuar informacionin e mundshëm për vendndodhjen aktuale të tyre. Jo më vonë se 10 ditë nga aktualizimi i gjendjes për çdo familje ose shtetas, zyra e gjendjes civile të bëjë njoftimet për zyrat e gjendjes civile të bashkive apo komunave ku, sipas informacionit të marrë, ata banojnë aktualisht.

5. Zyrat e gjendjes civile të çdo bashkie e komune, mbi bazën e informacioneve që sigurojnë nga bashki e komuna të tjera, si dhe nga informacioni që sigurojnë vetë të dërgojnë në çdo familje të ardhur njoftimin për të paraqitur në atë zyrë kërkesën për lëvizjen e dokumenteve të gjendjes civile, në rastet kur kanë siguruar banesë (të blerë, me qira ose të strehuar tek persona të tjerë), sipas pikës 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.14, datë 24.1.1994, ose për t'u evidentuar si banorë të përkohshëm. Për këtë, kryetari i bashkisë ose komunës, mbi bazën e një ndarje pune, të angazhojë edhe punonjës të tjerë të administratës e të institucioneve të juridiksionit të njësisë vendore, në ndihmë të zyrës së gjendjes civile.

6. Në rastet kur edhe pas njoftimit të bërë, familja apo shtetasi i veçantë nuk paraqesin kërkesë, nga zyra e gjendjes civile ku ndodhet shtetasi, duhet të aplikohet gjobë, në përputhje me pikën 2/2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.14, datë 24.1.1994. Gjoka përcaktohet nga këshilli i bashkisë e komunës, me propozim të kryetarit të bashkisë ose komunës, në përputhje me ligjin për kundërvajtjet administrative.

7. Këshillat e bashkive dhe komunave të ushtrojnë të drejtën e tyre, që rrjedh nga pika 2 e nenit 16 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", për të mos aplikuar përkohësisht taksën e regjistrimit kur mendojnë se ajo kthehet në favor pengues në këtë proces.

8. Në bazë të pikës 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.55, datë 2.2.2001 "Për organizimin e strukturës së zyrave të gjendjes civile", prefektët të kontrollojnë veprimtarinë që kryhet nga zyrat e gjendjes civile dhe në përputhje me pikën 3/c të nenit 31 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000, të kërkojnë pranë këshillave të bashkive e të komunave, ku e gjykojnë të nevojshme, shqyrtimin e këtij problemi dhe marrjen e masave.

9. Të përdoren të gjitha mënyrat për të sensibilizuar opinionin publik për nevojën e pasqyrimin real të dokumentacionit të gjendjes civile, si domosdoshmëri për të siguruar të drejtat ligjore të shtetasve dhe për t'u shërbyer më mirë atyre.

MINISTRI I PUSHTETIT VENDOR
DHE DECENTRALIZIMIT
Ben Blushi

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 26. 8. 2002
Doli nga shtypi më 28. 8. 2002

Tirazhi: 4250 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 100 lekë

